



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:099532
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523807

Ac.nr.5900/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hunaida Pasuli, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Ardian Ajvazi, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.S. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.Q, avokat në Gjilan, kundër të paditurës R.K. nga Gjilani, rr. “.....” pn., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.H., avokat në Gjilan, për krijimin e servitutit sendor, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.504/2015 datë 07.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit N.S. nga Gjilani, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.504/2015 i datës 07.08.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.504/2015 të datës 07.08.2020, ka vendosur si në vijim:

REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit N. Sh.S. nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurës R.K. nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që të krijohet e drejta e servitutit-kalimit në dobi të njësisë kadastrale dominuese P-.....në sipërfaqe prej m² dhe njësisë kadastrale dominuese P-.....në sipërfaqe prej m², Zona Kadastrale në Gjilan, e regjistruar në emër të paditësit si pronar N.SH.S. nga Gjilani, për kalim në këmbë dhe me auto vetura nëpër njësinë

kadastrale shërbyese P-....., në sipërfaqe prej m², Zona Kadastrale në Gjilan, e regjistruar në emër të të ndjerit M. J.K. ish nga Gjilani, tani në posedim të trashëgimtares, të paditurës R.J. K nga Gjilani, dhe atë në pjesën veri-perëndimore të parcelës kadastrale shërbyese në gjerësi prej 2 m e në gjatësi prej 93.03 m, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 186m, e që në tërë gjatësinë kufizohet me njësinë fqinjë nr.206.

II Anulohet Masa e Përkohshme e Sigurisë, e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.504/15 e datës 01.09.2015.

III DETYROHET paditësi që përfaqësuesit të paditurës t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 810 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë paditësi përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që me aprovimin e kërkesëpadsisë së paditësit të krijohet e drejta e servitutit - kalimit në dobi të ngastrave kadastrale dominuese e regjistruar në emër të paditësit si pronar duke e detyruar të paditurën që të kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, sipas llogarisë e cila është dhënë në shpjegimet përfundimtare.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i padituri, me të cilën ka propozuar që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet, ndërsa ankesa e palës paditëse të refuzohet si e pabazuar në ligj e po ashtu të obligohet paditësi t'i paguan edhe shpenzimet e procedurës komform tarifës së OAK-së, të gjitha këto me kamatë ligjore si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se

Ankesa e paditësit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, me datë 31.08.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi për krijimin e servitutit sendor, kundër të paditurës, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, me arsyet sikurse në padi dhe në propozim.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.504/2015 të datës 07.08.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata ka theksuar se me daljen në vendshikim është konstatuar që paditësi asnjëherë nuk e ka shfrytëzuar këtë rrugë, që nga koha e blerjes së pronës, e deri më tani dhe nuk ka paraqitur padi brenda periudhës kohore të përcaktuar me ligj, Pretendimet e paditësit se me rastin e blerjes së paluajtshmërisë ishte arritur marrëveshje mes shitësit dhe bashkëshortit të paditurës që t'i lejohet paditësit e drejta e kalimit, këto pretendime gjykata i vlerësoi si të pambështetura në prova të besueshme. Gjykata ka parashtruar se nga dalja në terren bashkë me ekspertin e gjeodezisë ka rezultuar se paditësi ka mundësi alternative për t'u qasur në rrugë publike më të afërt dhe me pak dëm nëpër titullar të pronave, e sidomos nga pjesa lindore e kësaj njësie ku ishte rruga në kufi të njërive kadastrale ashtu siç edhe mund shihet nga skica e matjes e gjendjes faktike në terren. Në vlerësimin e fakteve vendimtare gjykata besimin ia fali deklarimeve të të paditurës dhe të dëshmitarit S.S. ndërsa deklaratës së dëshmitarit I.J., të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor gjykata nuk ia fali besimin e plotë,

me arsyetimin se ishte në kundërshtim me provat materiale në shkresat e lëndës, gjegjësisht me deklaratën e dhënë nën betim.

Për bazën juridike gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 253 paragraf 1 dhe 2 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, nenit 58 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore - Juridike, lidhur me nenin 143 të LPK-së. Vendimin mbi shpenzimet e procedurës ka mbështetur në nenin 452 paragraf 1 dhe 463 paragraf 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par. 2 pika n) të LPK-së për shkak se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka dhënë arsye edhe për besueshmërinë e mjeteve provuese me të cilat ka vërtetuar faktet kontestuese si dhe ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e kualifikimit të fakteve në raport me normat materialo-juridike të cilat janë zbatuar në rastin konkret. Kronologjia e arsyetimit të vendimit sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit paraqet një përmbajtje koherente, për përfundimin ligjor lidhur me pabazueshmërinë e kërkesëpadsisë. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare duke specifikuar se si i ka vërtetuar faktet, cilat prova i ka shfrytëzuar, si i ka vlerësuar ato për vërtetimin e secilit fakt dhe për fuqinë provuese të tyre, e po ashtu ka arsyetuar se si ka arritur në përfundimin për refuzimin e kërkesëpadsisë si të pabazuar.

Gjykata e Apelit si të pambështetura i vlerëson pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit, të gjitha faktet vendimtare i ka provuar me mjete të përshtatshme dhe të besueshme provuese dhe rrjedhimisht edhe i ka arsyetuar të njëjtat në raport me normën e zbatuar. Gjykata e Apelit, vëren se nga provat që janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se paluajtshmëria në të cilën paditësi kërkon të drejtën e kalimit, nuk është pronë e të paditurës, por e njëjta paluajtshmëri evidentohet në emër të J.M.K., ashtu siç është përshkruar në ekspertizën e gjeodezisë të datës 10.11.2019. Ekspertiza, i është dorëzuar palëve ndërgjyqëse para se e njëjta të administrohej si provë në seancën e shqyrtimit kryesor, e që nga kjo rrethanë faktike kuptohet se paditësi ka qenë në dijeni me konstatimet në ekspertizë, të cilës i ishte bashkëngjitur edhe certifikata pronësore si dëshmi. Ndërkaq i autorizuari i paditësit dhe as paditësi, nuk kanë kërkuar sqarime shtesë dhe as nuk kanë bërë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv për përfshirjen eventuale të pronarit të pasurisë si palë e paditur në procedurë. Në rrethanat e tilla të konstatuara rezulton se këtu e paditura nuk ka legjitimitetin e palës në procedurë e që paraqet rrethanë të mjaftueshme që kërkesëpadsia, të refuzohet e pabazuar në raport me të paditurën R.K Përfundimisht, nga kjo gjendje e fakteve gjykata ankimore pa u lëshuar në vlerësime tjera sa i përket të drejtës materiale të zbatuar, konsideron se në rastin konkret, nga arsyet e parashtuara aktgjykimi i atakuar duhet të vërtetohet. Prandaj me refuzimin e ankesës së paditësit, kolegji i kësaj gjykate vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:099532
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523807

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr. 5900/20, me datë 21.03.2024

Kryetarja e kolegjit
Hunaida Pasuli